



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 137 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 20/ 09 / 2023

VENDIM

Nr. 34, date 20/09/2023

PËR

**PLANET E GADISHMERISE NE RASTET E EMERGJENCAVE CIVILE PER 5 DIGAT E
MEDHA TE SHFRYTEZUARA NGA BASHKIA SKRAPAR**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 20.09.2023 mori në shqyrtim Planin e Gadishmerise ne rastet e emergjencave civile per 5 digat e medha te Vendreshes, Liqeth, Rog, Staravecke dhe Kuc qe shfrytezohen nga Bashkia Skrapar

Planet e Gadishmerise ne rastet e emergjencave civile per 5 digat e medha te pregatitur nga specialistët e Bashkise Skrapar te dorëzuara pranë KKDM rezulton se jane pregatitur ne perputhje me kerkesat e KKDM per hartimin e ketyre planeve te dhena ne Vendimin e KKDM Nr. 5, dt.16.11.2020.

Keshilli Teknik i Perhershëm i Digave (KTPD) i rekomandoi antareve te KKDM të miratoj Planet e emergjencave civile te paraqitur nga Bashkia e Skrapar. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Të miratoj Planet e Gadishmerise per rastet e emergjencave civile te 5 digave të medha te Vendreshes, Liqeth, Rog, Staravecke dhe Kuc te shfrytëzuara nga Bashkia Skrapar.
- 2- Ti kërkoj Bashkise Skrapar:
 - Përgatitjen e hartave te permbytjeve ne rastet e prurjeve maksimale me perseritje nje here ne 1000 vjet dhe ne rast te prishjes se mundshme te ndonje prej ketyre digave
 - Instalimin e sistemeve te Alarmit ne seicilen prej ketyre digave
 - Informacion per digat qe kane humbur funksionin ose jane aktualisht jasht funksionit per shkak te demtimeve apo mbushjes me sedimente si dhe per njerezit ne rrezik ne zonen urbane poshte ketyre digave. Ky informacion te dergohet prane KkDM brenda muajit Tetor 2023

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI
Arjan JOVANI

